

14 qershor 2012, Prizren

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Menaxhim i dobët i buxhetit të shkollave dhe Shërbime jocijësove shëndetësore

EC Ma ndryshe edhe gjatë muajit maj ka vazhduar me monitorimin e punës së ekzekutivit komunal të komunës së Prizrenit. Ajo çka vlen të potencohet se gjatë kësaj periudhe nuk janë publikuar në ueb faqe vendimet (konkluzionet) e Kryetarit të Komunës së Prizrenit për muajin Maj 2012; që dëshmon mungesë transparence të ekzekutivit komunal në raport me qytetarët. EC Ma Ndryshe kërkon nga Kryetari i Komunës së Prizrenit që mbledhjet e e tij me drejtorët e drejtorive (Bordi) të jenë të hapura për shoqërinë civile dhe mediat me qëllim që të rritet transparenca në marrjen e vendimeve nga ana e ekzekutivit komunal.

Po ashtu, monitoruesit kanë pasur edhe takime të shumta me drejtorët e shkollave si dhe personelin arsimor. Në bazë të ligjit për prokurimin publik të Kosovës autoriteti kontraktues do t'u dërgojë njëkohësisht, së paku tre (3) operatorëve ekonomik një kërkesë me shkrim për kuotimin e çmimeve dhe aq sa është e mundur, sa më shumë operatorëve ekonomik sa është e nevojshme për të siguruar se konkurrenca efektive për kontratën përkatëse nuk dëmtohet. Drejtorët nuk e respektojnë këtë dispozitë ligjore dhe për më tepër nga ana e vetë drejtorëve kërkohet që firma t'i sigurojë ofertat me qëllim të mbulimit të procedurave me letra. Po ashtu nga vetë drejtorët është pohuar se nuk kanë aftësim të duhur për të menaxhuar me sukses buxhetin duke e vënë theksin edhe në mungesën e një zyrtari financiar në shkollë.

EC Ma ndryshe shpreh shqetësim për mënyrën e menaxhimit të financave nga ana e drejtorëve të shkollave ku lihet hapësirë e madhe për menaxhim joefikas dhe shpërdorim të parashë publike. Andaj kërkohet nga ana e DKA-së që të ketë një kontroll më efektiv mbi drejtorët e shkollave sa i përket menaxhimit të financave si dhe të vazhdojë të trajtojë drejtorët në fushën e menaxhimit të financave.

Gjatë kësaj periudhe të monitorimit është vërejtur edhe cilësi e dobët në investimet kapitale në shkollë. Disa nga objektet shkollore që janë ndërtuar së fundmi nuk janë të cilësisë së duhur. Çarjet e mureve të shkollave, prishjet e nyejve sanitare në objektet shkollore janë ndër problemet më kronike që përcjellin investimet në këtë lëmi. Mungesa e llogaridhënies dhe pranimit teknike pa ndonjë kriter nga ana e organit mbikëqyrës (komuna) kundrejt operatorëve ekonomik për objektet shkollore të investuara tregon për keqpërdorimet e mundshme nga ana e zyrtarëve të qeverisë lokale. EC Ma Ndryshe shpreh shqetësimin se si tolerohen gjërat e tilla nga ana e institucioneve relevante andaj kërkohet që të hetohen të gjitha rastet e tilla dhe të obligohen OE-të që të sajohet prishjet kaq të shpejta të objekteve shkollore.

Një tjetër segment i monitorues, ai i ofrimit të shërbimeve shëndetësore, tregon për mungesën e cilësisë së këtyre shërbimeve të ofruara për qytetarët e Prizrenit. Pauzat e gjata të stafit mjekësor, detyrimi për caktimin e terminit për analizat e gjakut (dy apo tri ditë përpara) si dhe mungesa e barnave të listës esenciale janë dëshmi e mjaftueshme që niveli i kujdesit primar shëndetësor është në gjendje jo të mirë. Prandaj, qeveria lokale bashkë me stafin drejtues të institucioneve të shëndetit primar duhet të ndërmarrë veprime të menjëhershme për sanimin e kësaj gjendjeje në ofrimin e shërbimeve mjekësore për qytetarët e Prizrenit.

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së ekzekutivit do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe prej muajit qershor përmes web-faqes së projektit, ku të gjeturat do të postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Duke filluar nga 18 qershori 2012, të gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e

rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me qeverinë lokale të Prizrenit do të publikohen në baza të rregullta në web-faqen e projektit, www.online-transparency.org

Dy segmentet e reja të monitorimit në kuadër të këtij projekti janë urbanizmi dhe kultura. Monitoruesit e EC Ma Ndryshe janë në fazën e mbledhjes së të dhënave dhe dëshmive në lidhje me ndërtimet jashtë kriterëve urbanistike që kanë ndodhur kohëve të fundit në Qendrën Historike të Prizrenit. Paralelisht, është duke u zhvilluar procesi i monitorimit të politikave kulturore në nivel lokal, me theks t'i veçantë në mënyrën e ndarjes dhe shpenzimit të buxhetit për kulturë. Me të dhëna konkrete dhe rezultate prekëse të monitorimit në këto dy fusha, EC Ma Ndryshe do të dalë me komunikata të reja gjatë pjesës së dytë të qershorit. Të njëjtat të gjetura do të publikohen edhe në web-faqen e projektit.

Ju falemnderit për bashkëpunimin tuaj,

Hajrulla Çeku, drejtor ekzekutiv
OJQ EC Ma Ndryshe
Rr. Ismet J. Kumanova, Nr. 31 - Prizren
Rr. Zeki Shulemaja, Nr. 2 - Prishtinë
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
+381 38 522 199 & +386 49 116 448

Projekti "Transparenca on-line e komunës së Prizrenit" mbështetet financiarisht nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur

SOROS

Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovo Foundation for Open Society
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo